

Microsoft Albania sh.p.k.
Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	
Pasqyra e pozicionit financiar	4
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse	5
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	6
Pasqyra e flukseve të parasë	7
Shënimet e pasqyrave financiare	8 – 38

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Aksionarëve dhe Drejtuesve të Microsoft Albania Sh.p.k,

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të Microsoft Albania SHPK ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare të veçanta për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Bazat për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e drejtuesit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtuesit, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare drejtuesit është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtuesit ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontroleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontroleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtuesit.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtuesit, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania sh.p.k

Deloitte Audit Albania sh.p.k

Rr. Faik Konica, Ndërtesa nr. 6, Hyrja nr. 7, 1010 Tirana, Albania

Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS): L41709002H



Enida Cara
Auditues ligjor
Partner Angazhimi

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Enida Cara".

4 qershor 2021
Tiranë, Shqipëri

	Notes	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019 (e rideklaruar)
Aktivitet			
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	7	7,269	12,656
E drejta e përdorimit të aktiveve	8	8,016	12,488
Aktive tatimore të shtyra		1,104	633
Totali i aktiveve afatgjata		16,388	25,777
Aktivitet afatshkurtra			
Parapagime dhe shpenzime të periudhave të ardhme	9	1,668	1,741
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	10	59,026	53,039
Aktive tatimore	11	8,059	-
Paraja dhe ekuivalentet e saj	12	24,451	51,332
Totali i aktiveve afatshkurtra		93,203	106,111
Totali i aktiveve		109,592	131,888
Kapitali dhe detyrimet			
Kapitali aksionar	13	100	100
Fitimi i pashpërndarë		95,013	108,424
Totali i kapitalit		95,113	108,524
Detyrimet afatgjata			
Detyrime afatgjata qiraje	14	3,584	8,063
Totali i detyrimeve afatgjata		3,584	8,063
Detyrimet afatshkurtra			
Detyrime afatshkurtra qiraje	14	4,608	4,344
Detyrime kontraktuale	15	4,341	3,558
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	16	92	135
Provizione për detyrime tatimore	17	1,854	1,854
Detyrime tatimore	18	-	5,410
Totali i detyrimeve afatshkurtra		10,895	15,301
Totali i detyrimeve		14,479	23,364
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		109,592	131,888

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm më 4 Qershor 2021 dhe janë firmosur nga:

Joli Pijaneci
Perfaqësuese Ligjore




Përgatitur nga:
Ernst & Young Albania sh.p.k

Anisa Josimi




Shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Microsoft Albania sh.p.k.**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019 (e ridekluar)
Te ardhurat	19	22,789	111,045
Shpenzime personeli	20	(3,567)	(17,480)
Shpenzime operative të tjera	21	(6,906)	(30,225)
Shpenzime amortizimi	7, 8	(9,695)	(10,571)
Fitimi operativ		2,622	52,769
Shpenzime interesi	22	(238)	(333)
Humbje nga kursi i këmbimit, neto	23	(953)	(97)
Fitimi para tatimit		1,431	52,339
E ardhura / (shpenzimi) i tatimit mbi fitimin	24	157	(8,981)
Fitimi neto për vitin		1,588	43,358
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		1,588	43,358

Shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Microsoft Albania sh.p.k.**Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

Shënime	Kapitali aksionar	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	100	85,067	85,167
Fitimi neto i vitit	-	53,747	53,747
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse	-	53,747	53,747
Dividend i paguar për vitin	-	(20,000)	(20,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	100	118,814	118,914
Korrigjimi	6	(10,390)	(10,390)
Gjendja më 31 dhjetor 2019 (e rideklaruar)	6	108,424	108,524
Gjendja më 1 janar 2020	100	108,424	108,524
Fitimi neto i vitit	-	1,588	1,588
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse	-	1,588	1,588
Dividend i paguar për vitin	-	(15,000)	(15,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	100	95,012	95,112

Shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019 (I rideklaruar)
AKTIVITETE OPERATIVE		
Fitimi para tatimit	1,431	52,339
Rregullime për:		
Amortizimin e aktiveve afatgjata materiale	7	6,288
Amortizimin e te drejtes se përdorimit të aktiveve	8	4,283
Flukset e parasë nga aktiviteti operativ përpara ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative	11,290	62,910
<i>Ndryshimi në kapitalin punues</i>		
Rënie në parapagime dhe shpenzime të periudhave të ardhme	73	313
Rritje në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(5,987)	(8,444)
Rritje / rënie në aktivet tatimore	(1,826)	5,756
Rënie / rritje në detyrimet kontraktuale	783	(13,216)
Rënie në llogaritë e pagueshme dhe detyrime tatimore	(43)	(18,403)
Rritje / rënie në detyrimet e qirasë	206	(890)
Interesi për detyrimin e qirasë	238	333
Tatimi fitimi i paguar	(11,955)	(6,160)
Flukset e parasë neto të përdorura / nga veprimtaria operative	(7,221)	22,199
AKTIVITETE INVESTUESE		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	-	(901)
Flukset e parasë neto të përdorur në aktivitetet investuese	-	(901)
AKTIVITETE FINANCUESE		
Pagesat e principalit të qirasë	26	(4,541)
Divident i paguar		(20,000)
Flukset e parasë neto të përdorur në aktivitetet financuese	(19,660)	(24,541)
Rënie neto e parasë	(26,881)	(3,243)
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit	51,332	54,575
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit	12	51,332

1. TË PËRGJITHSHME

Microsoft Albania ("Shoqëria") u themelua më 30 qershor 2008 si Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe u regjistrua sipas vendimit të gjykatës në të njëjtën datë, me NIPT K8183001C dhe numër serial certifikate: SN-055925-05-09.

Aksionari i Shoqërisë është Microsoft Corporation (Shoqëria Meme), e cila zotëron 100% të aksioneve. Microsoft është një korporatë software-sh me bazë në SHBA, e regjistruar më 22 shtator 1993, me seli në Redmond, Washington.

Microsoft Corporation është entiteti kontrollues i drejtpërdrejtë dhe përfundimtar i Shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është ofrimi i shërbimeve për zhvillimin e tregut, shërbimet te kualifikuara dhe shërbimet që lidhen me software dhe hardware kompjuterike, përfshirë pa asnjë kufizim, shërbime teknike, trajnime dhe këshillime.

Më 31 dhjetor 2020, Shoqëria ka 2 punonjës (2019: 1). Zyrat e Shoqërisë ndodhen në Rr. Papa "Gjon Pali II", ABA Business Center, Floor 12/5, 1000, Tiranë, Shqipëri, qe nga Janari 2018 (adresa e mëparshme ka qenë Rr. "Abdyl Frasherit", P.11/1, EGT Tower 2nd floor, Tiranë, Shqipëri).

Drejtuesit dhe Manaxherët më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë

Benjamin Owen Orndorff	Administrator
Keith Ranger Dolliver	Administrator
Sokol Vladi	Drejtor i Përgjithshëm deri ne 31.10.2019
Ervin Nallbani	Perfaqesues Ligjor deri ne 15.02.2020
Joli Pijaneci	Perfaqesuese Ligjore nga 15.02.2020

2. BAZA E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të cilat janë publikuar dhe nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë te kostos historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë paraqitur në monedhën Leke Shqiptarë ("LEK"), dhe të gjitha vlerat janë rumbullakosur në mijëshen me të afërt "000 lekë" përveçse kur tregohet ndryshe. LEK është monedha funksionale dhe e paraqitjes se Shoqërisë.

Pasqyrat financiare ofrojnë informacion krahasues në lidhje me periudhën e mëparshme. Për më tepër, Shoqëria paraqet një pasqyrë shtesë të pozicionit financiar dhe pasqyrës së fitimit dhe humbjes dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të periudhës së mëparshme, pasi ka një rideklarim të zërave në pasqyrat financiare, për shkak të një korrigjimi te kryer ne menyre retrospektive të një gabimi te periudhes se meparshme. Shikoni Shënimin 6

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave te raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën këto vlerësime janë rishikuar dhe në periudhat e ardhshme që ndikohen.

2. BAZA E PËRGATITJES (VAZHDIM)

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve (vazhdim)

Parimi i vijimërisë

Drejtimi i ka përgatitur Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 mbi bazën e parimit të vijimësisë, i cili supozon vazhdimësinë e aktivitetit aktual të biznesit dhe realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve në rrjedhën e zakonshme të aktivitetit biznesor.

Vlerësimi i ndikimit të COVID-19 në shoqëri.

Në Mars të vitit 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli perhapjen e COVID-19 si një pandemi. Pandemia e COVID-19 mund të vazhdojë të ndikojë në operacionet tona biznesore dhe në rezultatet e operacionale financiare, dhe mund të ketë pasiguri të qenesishme në natyrën dhe shkallën e efekteve të vazhdueshme të saj me kalimin e kohës. Deri më sot Shoqëria nuk ka identifikuar ndikime të konsiderueshme negative si rezultat i ndikimit të COVID-19 të cilat mund të shërbejnë për të hedhur dyshime në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e sa sipas parimit të vijesise ne te ardhmen.

Strukturat globale dhe lokale të drejtimit të Shoqërisë vazhdojnë të monitorojnë nga afër situatën COVID-19, të parashikojnë dhe të reagojnë ndaj rrethanave të ndryshme. Për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e punonjësve, furnitorëve dhe klientëve tanë, Shoqëria ka bërë modifikime thelbësore në politikën e udhëtimit të punonjësve, ka mbyllur ambientet fizike të zyrave dhe i ka udhezuar punonjësit të punojnë nga shtëpia si dhe anuloi ose zhvendosi afatet e konferencave dhe eventeve të tjera të zhvillimit të tregut për të kryer vetëm virtualisht në vitin 2021.

Shkalla në të cilën pandemia e COVID-19 do ndikojë me tej mbi aktivitetin e Shoqërisë varet nga faktorë të shumtë të ndryshueshëm të cilët nuk mund t'i parashikojmë me besueshmëri dhe që përfshijnë, kohëzgjatjen dhe fushën e veprimit të pandemisë, veprimet e qeverisë, bizneseve dhe individëve në përgjigje të pandemisë dhe ndikimi në aktivitetin ekonomik, duke përfshirë mundësinë e recesionit ose paqëndrueshmërisë së tregut financiar. Këta faktorë mund të ndikojnë negativisht në planet e shpenzimeve të konsumatorëve individë, të bizneseve dhe të qeverisë në produktet e teknologjise se informacionit, si dhe në aftësinë e klientëve për të paguar për produktet dhe shërbimet e Shoqërisë në mënyrë të vazhdueshme. Kjo pasiguri ndikon gjithashtu vlerësimet dhe parashikimet e drejtimit dhe drejtimit financiar të Shoqërisë, të cilat mund të rezultojnë në ndryshueshmëri më të madhe në një larmi fushash që varen nga këto vlerësime dhe supozime, që përfshijnë investimet, të arkëtueshmet dhe udhëzimet e ardhshme.

Bazuar në marrëveshjen dypaleshe në fuqi midis entiteteve të Korporates Microsoft, që udhezoi modelin operacional të zbatueshëm për Shoqërinë, kësaj të fundit i garantohet një mbulim i kostove të saj lokale operacionale të periudhës në rast se ajo nuk ka gjeneruar të ardhura të mjaftueshme nga shërbimet ndaj klienteve që janë pale të treta (Shërbimet Microsoft të Konsulencës - MCS dhe Shërbimet Premier të Mbështetjes - PSS). Menaxhimi parashikon që brenda tremujorit të parë të 2021 do të nënshkruhen marrëveshje të reja të shërbimit PSS me kliente që janë agjensi shtetërore vendase si dhe me klientët e tjerë biznese private, sipas shënimit 29, të cilat do të rrisin ndjeshëm burimet e jashtme të të ardhurave dhe performancën financiare të Shoqërisë. Gjithashtu, bazuar në një marrëveshje tjetër midis entiteteve të Korporates Microsoft, për centralizimin e qarkullimit të mjeteve monetare, Shoqëria mund të kërkojë të terheqë në çdo kohë mjete monetare nga gjendja e saj e llogarise të arketueshme nga komisionet, për nevojat e menjshme operacionale të saj.

Manaxhimi nuk pret ndonjë ndryshim të qënësishëm në aktivitetin e Shoqërisë. Manaxhimi e ka vlerësuar ndikimin financiar të COVID-19 në operacionet, aftësinë paguese dhe likuiditetin e Shoqërisë dhe deri më sot nuk ka identifikuar ndonjë ndikim të rëndësishëm si rezultat i COVID-19 për të hedhur dyshime në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë ekonomike bazuar në parimin e vijimësisë



2. BAZA E PËRGATITJES (VAZHDIM)

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve (vazhdim)

Klasifikimi si afatshkurtër dhe afatgjatë i zërave të pasqyrave financiare

Shoqëria i paraqet aktivet dhe detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar bazuar në klasifikimin si afatshkurtër / afatgjatë. Një aktiv konsiderohet si afatshkurtër kur:

- Ai pritet që të realizohet apo synohet që të shitet ose konsumohet brenda ciklit normal të veprimtarisë operacionale të Shoqërisë
- Mbahet kryesisht për qëllime të tregtimit
- Pritet që aktivi të realizohet brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit

Ose

- Është në formën e mjeteve monetare ose të një aktivi ekuivalent të mjeteve monetare, me përjashtim të rastit kur ai kufizohet për t'u përdorur për këmbim ose për shlyerjen e një detyrimi për të paktën dymbëdhjetë muaj mbas periudhës së raportimit

Të gjitha aktivet e tjera do të konsiderohen si afatgjata.

Një detyrim është afatshkurtër kur:

- Pritet që të shlyhet gjatë ciklit normal të veprimtarisë operacionale të Shoqërisë
- Mbahet kryesisht për qëllime të tregtimit
- Do të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit

Ose

- Nuk ka të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit.

Shoqëria i klasifikon të gjitha detyrimet e tjera si afatgjata.

Aktivitet dhe detyrimet e tatimeve të shtyra klasifikohen si aktive dhe detyrime afatgjata.

Treguesi i realizimit të shërbimeve

Njohja e të ardhurave bazohet në treguesit e realizimit të shërbimeve të kryera. Drejtimi kryen vlerësimin e vet se si do të matet puna e realizuar, kjo punë do të miratohet nga inxhinierët dhe treguesi i realizimit do të bazohet mbi numrin e orëve të punës faktikisht të shpenzuara kundrejt totalit të numrit të orëve të parashikuara për kryerjen e punës. Detajet janë prezantuar në shenimin 3.5.

Njohja e aktivitetit të shtyrë

Njohja e aktivitetit të shtyrë bazohet në faktin nëse ka më shumë mundësi sesa jo që të ketë fitime të mjaftueshme në dispozicion në të ardhmen, kundrejt të cilave mund të zbriten diferencat e përkohshme. Njohja pra, përfshin gjykim në lidhje me rezultatet e ardhshme të Shoqërisë.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen fillimisht me kursin e këmbimit funksional të monedhës në datën në të cilën ky transaksion do të njihet. Aktivitet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedha të huaja janë përkthyer në monedhën funksionale (LEK) me kursin e këmbimit të datës së raportimit. Diferencat që vijnë nga shlyerja ose konvertimi i zërave monetarë njihen në fitim ose humbje, me përjashtim të zërave monetarë që përcaktohen si pjesë e investimit të Shoqërisë në një aktivitet (investim) të huaj, nëse ka, të cilat njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) derisa investimi neto të shitet, në të cilin moment, shuma kumulative do të riklasifikohet në fitim ose humbje. Detyrimet apo aktivitetit të shtyrë që i atribuohen diferencave nga kursi i këmbimit mbi zërat monetarë që njihen në ATGJ gjithashtu do të njihen në ATGJ.

Shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Zerat jo-monetarë të bilancit që maten me kosto historike në një valutë të huaj konvertohen duke përdorur kurset e këmbimit në datat e transaksioneve fillestare. Zerat jo-monetarë të matur me vlerë të drejtë në një valutë të huaj konvertohen duke përdorur kurset e këmbimit të datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Fitimi ose humbja që rrjedh nga konvertimi i zërave jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë trajtohet në të njëjten mënyrë me njohjen e fitimit ose humbjes nga ndryshimi në vlerën e drejtë të zërit në fjalë.

Kursi efektiv në fund të vitit ndërmjet LEK'ut dhe monedhave të tjera është si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
USD	100.84	108.64
EUR	123.70	121.77

3.2 Aktivët afatgjatë materiale

Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjatë materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo zhvleresim të akumuluar të vlerës së tij. Punimet në proces, maten me kosto, minus humbjet nga zhvleresimi, nëse ka. Kjo kosto përfshin koston e zëvendësimit të makinerive dhe pajisjeve si dhe kostot e huamarrjes në rastin e projekteve afatgjatë të ndërtimit nëse janë permbushur kushtet për njohjen e aktivitetit.

Kosto e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe koston direkte të punës, çdo kosto tjetër të përfshirë direkt në sjelljen e aktivitetit në kushte pune për qëllimin e përcaktuar, kostot e çmontimit dhe largimit të pjesëve dhe restaurimit të vendit në të cilin ato janë vendosur si dhe kostot e kapitalizuara të huamarrjes.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjatë materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme njihen në kontabilitet si elemente të veçante (komponente kryesore) të aktiveve afatgjatë materiale.

Një ze aktiv afatgjatë material apo një komponent kryesor i një aktiviteti i njohur individualisht, çregjistrohet në momentin kur aktiviteti shitet (dmth në datën kur blerësi merr kontrollin mbi aktivitetin) ose kur nuk priten përfitime ekonomike në të ardhmen nga përdorimi apo shitja e tij.

Të ardhurat apo humbjet që lindin në momentin e çregjistrimit të një aktiviteti afatgjatë material (te llogaritura si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës së tij kontabël neto) njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktiviteti çregjistrohet.

Kostot të mëpasshme

Nëse është e mundshme që përfitime ekonomike që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në të ardhmen në Shoqëri dhe kostoja e tyre mund të maten në mënyrë të besueshme, kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një elementi të aktiveve të trupëzuara njihet me vlerën kontabël të elementit. Vlera e mbetur e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjatë materiale njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave në momentin kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivitetit, ose një vlerë zëvendësuese e koston, minus vlerën e tij të rikuperueshme. Amortizimi njihet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave sipas bazës lineare përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të secilit grup të aktiveve afatgjatë materiale, duke qenë se kjo e reflekton më mirë modelin e pritshëm të konsumimit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të trupëzuara në një aktivitet.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**3.2 Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)**

Toka nuk amortizohet. Jetëgjatësitë e vlerësuara për periudhën aktuale si dhe për periudhën krahasuese janë si më poshtë:

<i>Kategoritë</i>	<i>Vitet</i>
Pajisje zyre	3
Automjete	3
Mobilje dhe orendi	3
Pajisje dhe programe kompjuterike	1-2
Permiresimet të ambienteve të marra me qira	5

Shoqëria është palë e një marrëveshje qiraje që prej tetorit të 2017 për ambientet e zyrave të reja me një afat fillestar prej 5 vitesh, e cila mund të zgjatet edhe për një afat tjetër 5 vjecar, nëse palët bien paraprakisht dakord nëpërmjet një marrëveshje me shkrim. Në datën e fillimit të kontratës së qirasë, Shoqëria ka pritshmeri por nuk është teresisht e sigurte që do të ushtroje opsionin e rinovimit të kontratës, dhe në keto kushte Shoqëria e vlerëson jetëgjatësinë e aktivit "Punime permiresuese të ambienteve me qira" të jete e bashkerenduar me kohezgjatjen e afatit fillestar të qirase, dmth 5 vite, duke e amortizuar koston e ketyre permiresimeve në baze lineare përgjatë 5 viteve.

Metodat e amortizimit, jetëgjatësitë dhe vlerat e rikuperueshme rishikohen në fund të çdo viti financiar si dhe bëhen rregullime nëse është e përshtatshme.

3.3 Qiratë (E drejta e përdorimit të aktivit)

Në fillimin e një kontrate, Shoqëria vlerëson nëse kontrata është, ose përmban, një qira. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivit të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të një pagese monetare.

Shoqëria zbaton një qasje të vetme njohjeje dhe matjeje për të gjitha qiratë, përveç qirave afatshkurtra dhe qiramarjes së aktiveve me vlerë të ulët. Shoqëria njih detyrime qiraje për të kryer pagesat e qirase dhe të drejtën e përdorimit, si aktiv, që përfaqëson të drejtën e përdorimit të aktivit të marre me qira.

E drejta e përdorimit të aktivit

Shoqëria merr me qira ambientet për zyrën e saj. Shoqëria njih të drejtën e përdorimit të aktivit në datën e fillimit të qirasë (d.m.th., data kur aktiviteti është i disponueshëm për përdorim). E drejta e përdorimit të aktivit maten me kosto, minus çdo amortizim të akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi, si dhe e rregulluar për çdo ri-matje të detyrimit të qirasë.

E drejta e përdorimit të aktivit matet me kosto që përfshin:

- shumën fillestare të matur të detyrimit të qirasë;
- çdo pagesë të bërë para apo në datën e fillimit të qirasë, minus çdo incentiv qiraje të marrë, dhe;
- kostot e nevojshme për të rikthyer aktivin në gjendjen e përcaktuar në kontratën e qirasë.

Kostot fillestare direkte janë përjashtuar nga matja e të drejtës së përdorimit të aktivit në datën e zbatimit.

E drejta e përdorimit të aktiveve përgjithësisht amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër mes jetës së dobishme të aktivit dhe kohëzgjatjes së qirasë, duke përdorur metodën lineare. Nëse Shoqëria ka siguri të mjaftueshme që do të ushtrojë opsionin e blerjes, aktiviteti me të drejta përdorimi do të amortizohen përgjatë jetës së dobishme të aktivit.

Amortizimi i pjesëve të të drejtës së përdorimit të aktivit llogaritet duke përdorur metodën lineare mbi jetën e mbetur të përlllogarit. Jeta e dobishme e të drejtës së përdorimit të aktivit (ambientet e zyrës me qira) është 5 vjet.

Nëse pronësia e aktivitetit me qira transferohet të Shoqëria në fund të afatit të qirasë ose kostoja pasqyron ushtrimin e një opsioni blerjeje, amortizimi llogaritet duke përdorur jetëgjatësinë e vlerësuar të aktivitetit.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Qiratë (E drejta e përdorimit të aktivitetit) (vazhdim)

Detyrimet e qirasë

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria l një detyrimet e qirasë të matura me vlerën aktuale të pagesave që do të bëhen gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesat fikse të qirase minus ndonjë incentive qiraje të perfituar, nese ka, si dhe pagesat variable nese ka, të cilat varen nga koeficientet dhe norma indeksimi, si dhe nga shumat për tu paguar në baze të vlerave të mbetura sipas garancise, nese ka.

Pagesat e qirase përfshijnë gjithashtu vlerën e ushtrimit të opsionit të blerjes së aktivitetit nga qiramarrësi, kur ky opsion është mjaftueshmerisht i sigurte që do ushtrohet, si dhe pagesat e penaliteteve për ndërprerjen e hershme të kontratës së qirase, nese afati i qirase reflekton kushtin e ushtrimit të opsionit të ndërprerjes së kontratës nga Shoqëria.

Në llogaritjen e vlerës aktuale të pagesave të qirasë, Shoqëria përdor normën e saj të huamarrjes në datën e fillimit të qirasë sepse norma nominale e interesit në qira nuk është e përcaktuar. Pas datës së fillimit, shumata e detyrimeve të qirasë rritet për të reflektuar shpenzimet e interesit të llogaritur, si dhe zvogëlohet për pagesat e bëra të qirasë. Përveç kësaj, vlera kontabël e detyrimeve të qirasë ri-matet nëse ka ndonjë ndryshim në pagesat e qirase psh, ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë (p.sh., ndryshimet në pagesat e ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks ose normë të përdorur për të përcaktuar pagesat e qirasë) ose një ndryshim në vlerësimin e opsionit të ushtrueshem për të blerë aktivitetin e marre me qira.

Pagesat e qirase janë skontuar duke përdorur normën e huamarrjes të udhëzuar nga Microsoft Corporation (Shoqëria Meme) norme e cila përfaqëson normën që Shoqëria do të paguante për fonde të marra hua të nevojshme për të siguruar një aktiv me vlerë të ngjashme me aktivitetin me të drejtë përdorimi në një mjedis të ngjashëm ekonomik me terma, kushte dhe garanci të ngjashme.

Shoqëria gjithashtu ka vlerësuar nese norma e huamarrjes së zbatuar duhet rregulluar për të reflektuar mjedisin ekonomik si dhe monedhen në të cilën maten transaksionet e qirase.

Microsoft Corporation (Shoqëria Meme) dhe filialet e saj, duke përfshirë Shoqërinë, kanë një marrëveshje të centralizimit të qarkullimit të mjeteve monetare, ndërsa të cilës Shoqëria Meme rregullisht terheq nga entitetet filiale të saj mjetet monetare të akumuluar mbi nevojat, për menaxhimin në mënyrë të centralizuar të mjeteve monetare, dhe jua transferon ato filialeve bazuar në nevojat e tyre operacionale për likuiditet. I gjithë financimi i huave gjithashtu menaxhohet në mënyrë të centralizuar nga Microsoft (d.m.th.), filialet nuk marrin hua lokalisht në vendin ku operojnë. Prandaj, menaxhimi i Shoqërisë beson se nuk është i zbatueshem një rregullim i normës së skontimit për qëllim të pasqyrimit të mjedisit ekonomik vendas.

3.4 Instrumentat financiarë - njohja fillestare dhe matja e mëpasshme

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose një instrument kapitali të një njësie ekonomike tjetër.

Aktivitet Financiarë

Njohja dhe matja fillestare

Aktivitet financiarë klasifikohen, në njohjen fillestare, sipas kategorisë së matjes në instrumenta financiarë të matura me kosto të amortizuar, me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) apo me vlerë të drejtë përmes fitimit & humbjes. Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat kontraktuale të rrjedhës së parasë së instrumentit financiar dhe nga modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve. Shoqëria fillimisht mat një instrument financiar me vlerën e tij të drejtë plus kostot e transaksionit, në rastin e një aktiviteti financiar jo me vlerë të drejtë përmes fitimit & humbjes.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe matet me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë përmes ATGJ, ai duhet të krijojë flukse monetare që janë 'vetëm pagesa të principalit dhe interesit (SPPI)' mbi shumën kryesore të papaguar. Ky vlerësim referohet si testi SPPI dhe kryhet në një nivel instrumenti. Aktivitet financiarë me flukse parash që nuk janë SPPI klasifikohen dhe maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, pavarësisht nga modeli i biznesit.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Instrumentat financiare (vazhdim)

Matja e mëpasshme

Për qëllime të matjes së mëpasshme, aktivet financiare klasifikohen në katër kategori:

- Aktive financiare me kosto të amortizuar (instrumente borxhi)
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) me fitim dhe humbjeve kumulative të ricikluara (instrumenta borxhi)
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) pa riciklim të fitimeve dhe humbjeve kumulative pas cregjistrimit (instrumentet e kapitalit)

Aktivitet financiare me kosto të amortizuar (instrumentet e borxhit), më pas maten duke përdorur metodën e interesit efektiv (EIR) dhe janë subjekt i zhvlerësimit. Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivitet cregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet.

Metoda e normës së interesit efektiv

Metoda e normës së interesit efektiv është një metodë për llogaritjen e koston të amortizuar të një detyrimi financiar dhe për shpërndarjen e shpenzimit të interesit mbi periudhën përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma e cila skonton saktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuar përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, aty ku është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër.

Aktivitet financiare të Shoqërisë me kosto të amortizuar përfshijnë llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe mjete monetare dhe ekuivalentë të saj:

- Depozitat e parave të gatshme dhe ato afatshkurtra në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë paratë në bankë dhe depozitat afatshkurtra shumë likuide me një maturim prej tre muajsh ose më pak, të cilat janë lehtësisht të konvertueshme në parave të gatshme dhe janë subjekt të një risku të parëndësishëm në ndryshimin e vlerës.
- Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv minus humbjet nga zhvlerësimi.

Çregjistrimi i aktivitet financiar

Një aktiv financiar cregjistrohet kryesisht kur të drejtat për të marrë flukse parash nga aktivitet kanë përfunduar ose, Shoqëria ka transferuar të drejtat e saj për të marrë flukse monetare nga aktivitet ose ka transferuar të drejtat për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivitet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje likuidimi ndërkohë që (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon dhe as nuk mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk ruan kontrollin e këtyre aktiveve.

Zhvlerësimi

Një aktiv financiar që nuk matet me vlerën e drejtë përmes fitimit/humbjes, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar zhvlerësim. Një aktiv financiar ka pësuar zhvlerësim nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në zhvlerësim të tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitet, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në flukset e ardhshme të parasë nga aktivitet, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga zhvlerësimi i aktivitet të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël neto dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv. Humbjet njihen në pasqyrën e fitim & humbjes dhe reflektohen në një llogari provigjoni që është kundërpartit e llogarive të arkëtueshme.

Interesi nga aktivitet e zhvlerësuar vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shumat përkatëse rimerret nëpërmjet fitim ose humbjes.

Detyrimet Financiare

Njohja dhe matja fillestare

Shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Instrumentat financiare (vazhdim)

Detyrimet financiare (vazhdim)

Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, si detyrime financiare te matura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbje, kredi dhe hua, të pagueshme. Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e kredive dhe huave dhe të pagueshme, me vlere te drejte minus kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt.

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë detyrimet tregtare dhe të tjera të pagueshme, kredi, huamarje dhe instrumenta derivative financiare.

Matja e mëpasshme

Për qëllime të matjes së mëpasshme, detyrimet financiare klasifikohen në dy kategori:

- Detyrimet financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes
- Detyrimet financiare me kosto të amortizuar (kreditë dhe huamarrjet).

Detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes përfshijnë detyrimet financiare të mbajtura për tregtim dhe detyrimet financiare të përcaktuara në njohjen fillestare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të mbajtura për tregtim nëse ato kryhen me qëllim të riblerjes në afatin më të afërt.

Detyrimet financiare përcaktohen në njohjen fillestare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes në datën fillestare të njohjes, vetëm nëse kriteret e SNRF 9 janë përmbushur. Shoqëria nuk ka përcaktuar ndonjë detyrim financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Pas njohjes fillestare, kreditë dhe huatë me interes maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normes efektive te interesit (NEI). Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje apo incentive në blerje si dhe tarifatat ose kostot që janë pjesë integrale e metodes NEI.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme deklarohen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e normes efektive te interesit.

Huamarrjet

Huamarrjet fillimisht maten me vlerën e drejtë, minus kostot e transaksionit dhe më pas maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normes efektive te interesit, me shpenzimet e interesit të njohura në bazë të normës efektive të interesit.

Çregjistrimi

Një detyrim financiar çregjistrohet kur detyrimi përfundon ose anulohet. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër nga i njëjti huadhënës në mënyrë thelbësore me kushte të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues janë modifikuar në mënyrë thelbësore, një shkëmbim i tillë ose një modifikim i tillë trajtohet si çregjistrim i detyrimit origjinal dhe njohje i një detyrim të ri. Diferenca në vlerat përkatëse kontabël njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes

Aktivitet jo-financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jo financiare të Shoqërisë rishikohen në datën e raportimit në mënyrë që të përcaktohet nëse ka ndonjë të dhënë për zhvlerësimin e tyre. Nëse një e dhënë e tillë ekziston, në këtë rast vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është më e madhja midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Për vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të parasë skontojnë me vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivitetit për të cilin vlerësimet e flukseve të ardhshme të parasë nuk janë rregulluar.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktiviteti apo e njësisë të saj gjeneruese të parasë e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në humbje ose fitim.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.5 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga komisionet

E ardhura e komisioneve ne baze te marreveshjeve perkatese midis entiteteve te Microsoft, përfaqëson nje burim te brendshem te ardhurash me te cilat Korporata Microsoft shperblen filialet e saj vendore, perfshire Shoqerine, per aktivitetet qe keto te fundit kryejne per zhvillimit te tregut. Keto te ardhura njihen ne baze te shpenzimeve operative te ndodhura nga filialet vendore. Qellimi i Korporates Microsoft eshte qe duke i shperblyer filialet e saj vendore me te ardhurat e komisioneve, pervec te ardhurave qe filialet vendore te Microsoft gjenerojne nga kryerja e sherbimeve ndaj klienteve pale te treta, ato do te kene nje fitim te qendrueshem dhe do te sigurojne nje mbulim stabel te shpenzimeve totale operative.

Të ardhurat nga kontratat me klientët

Të ardhurat nga kontratat me klientët njihen kur kontrolli mbi mallrat apo shërbimet e furnizuara i transferohet klientit në një shumë që reflekton vlerën e arketueshme të cilën Shoqëria pret të perfitoje në këmbim të furnizimit të atyre mallrave apo shërbimeve. E ardhura matet me vlerën e drejtë të vlerës së arketueshme ose që priten të arkëtohet. E ardhura zvogëlohet me vlerën e perlogaritur të kthimeve nga klientët, uljeve apo zbritjeve të tjera ngjashme, nëse ka.

Te ardhurat nga shërbimet profesionale teknike Microsoft (MCS) dhe shërbimet mbështetëse Premier (PSS) ndaj kliente palë të treta sipas në kontratat perkatese te shërbimeve, njihen në bazë të fazës së përfundimit të shërbimeve, e cila matet në bazë të orëve të punës së shpenzuara të konsulentëve dhe burimeve të kontraktuara.

Shoqeria përdor një metodë e inputeve te shpenzuara në matjen e progresit të përfundimit të shërbimeve sepse kjo metode reflekton një lidhje te drejtpërdrejtë midis punes se kryer nga Shoqëria (d.m.th. te bazuar në orët e punës të kryera) dhe vlerës së shërbimit te transferuar klientit.

Kompania njej të ardhurat në bazë të orëve të punës të shpenzuara krahasuar me orët totale të të punës te parashikuara për të përfunduar shërbimin.

Kur shërbimet janë kryer nga një numër i pa-paracaktuar veprimesh përgjatë një peridhe të caktuar kohore, e ardhura njihet mbi bazë lineare përgjatë periudhës së specifikuar, për aq kohë sa nuk ka evidence se një metodë tjetër e përfaqëson më mirë fazën e përfundimit.

Aktivitet kontraktuale

Një aktiv kontraktual fillimisht njihet për të ardhurat e gjeneruar nga shërbimet ndaj klientëve sepse arketimi i vlerës është e diktuar nga përfundimi i suksesshëm i shërbimeve. Pas përfundimit të shërbimeve dhe pranimit nga klienti, shumata e njohur si aktiv i kontratës riklasifikohet në llogari të arketueshme tregtare.

Llogaritë e arketueshme tregtare

Një llogari e arketueshme njihet nëse një vlerë e arketueshme që është e pakushtëzuar, pritet te paguhet nga klienti (d.m.th., është vetem ceshtje kohe deri sa te realizohet arketimi i shumës).

Detyrimet kontraktuale

Një detyrim kontraktual njihet nëse është pranuar një pagesë apo pritet te merret nje pagese nga një klient përpara se Shoqëria të transferojë (furnizojë) shërbimet përkatëse. Detyrimet kontraktuale njihen si të ardhura nga Shoqëria kur ajo realizon shërbimet sipas kontratës (d.m.th., transferon kontrollin e shërbimeve tek klienti).

3.6 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi për llogaritë nëpër banka si dhe të ardhurat nga kurset e këmbimit, të cilat njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave. Të ardhurat nga interesi njihen në momentin që ato konstatohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Interesi periodik i konstatuar në aktivet financiare njihet në të ardhurat nga interesi.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.6 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare (vazhdim)

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa mbi huatë dhe detyrimet mbi qiranë, si dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Shpenzimet nga interesi njihen në momentin që ato konstatohen duke përdorur metodën e normes së interesit efektiv. Interesi periodik i konstatuar në detyrimet financiare njihet në shpenzimet e interesit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në bazë neto.

3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera

Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara në momentin që shërbimet janë kryer.

3.8 Tatimi

Tatimi mbi fitimin

Aktivi dhe detyrimi i tatimit mbi të ardhurat matet me shumën që pritet të rimburohet nga apo të paguhet tek autoritetet tatimore. Normat tatimore dhe ligjet tatimore të përdorura për llogaritjen e shumës së tatimit fitimit janë ato që janë miratuar në datën e raportimit në vendin ku Shoqëria operon dhe gjeneron të ardhura të tatueshme.

Detyrimi për tatim mbi të ardhurat që lidhet me zërat që njihen direkt në kapital dhe jo në pasqyrën e fitimit ose humbjes, njihet gjithashtu në kapital. Menaxhimi vlerëson në mënyrë periodike pozicionin e marrë nga Shoqëria në deklaratimet tatimore në lidhje me situatat në të cilat dispozitat e zbatueshme tatimore janë objekt i interpretimit dhe një provigjion kur është e përshtatshme.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit dhe llogaritet si tatimi i pritshëm për t'u paguar ose për t'u arkëtuar në lidhje me diferencat e përkohshme që ekzistojnë midis balancave të aktiveve dhe detyrimeve të njohura për qëllime të kontabilitetit dhe vlerave perkatëse të përdorura për qëllime tatimore.

Detyrimet për tatimin e shtyrë njihen për të gjithë diferencën e përkohshme të tatueshme, përveç:

- Kur detyrimi për tatimin e shtyrë lind nga njohja fillestare e emrit të mirë ose një aktivi/detyrimi në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe, në kohën e transaksionit, nuk prek as fitimin kontabël dhe as fitimin ose humbjen e tatueshme.

- Kur diferencat e përkohshme të tatueshme të lidhura me investimet në filiale, apo në interesa në sipermarrje të përbashkëta, ku koha e rimarrjes së diferencave të përkohshme mund të kontrollohet dhe nuk është e mundur që diferencat e përkohshme të rimerren në një të ardhme të parashikueshme.

Aktivet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, humbjet tatimore të mbartura dhe të papërdorura. Aktivet tatimore të shtyra njihen vetëm në masën që është e mundur që fitime të tatueshme të ardhshme do të jenë të disponueshme, kundrejt të cilave mund të zbriten diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbjet tatimore të mbartura dhe të papërdorura, përveç:

- Kur aktivi tatimor i shtyrë në lidhje me diferencën e përkohshme të zbritshme lind nga njohja fillestare e një aktivi ose detyrimi në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe, në kohën e transaksionit, nuk prek as fitimin kontabël dhe as fitimin ose humbjen tatimore.

- Në lidhje me diferencat e përkohshme të zbritshme të lidhura me investimet në filiale, në sipermarrje të përbashkëta, aktivet tatimore të shtyra njihen vetëm në masën që është e mundur që diferencat e përkohshme të rimerren në të ardhmen dhe të ekzistojnë një fitim tatimor i mjaftueshëm i ardhshëm mbi të cilin mund të shfrytëzohen diferencat e zbritshme.

Vlera kontabël e aktivitetit të tatimit të shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në atë masë sa nuk është më e mundur që fitimi i tatueshëm do të jetë i disponueshëm për të lejuar që të shfrytëzohet e gjitha ose një pjesë e aktivitetit të tatimit të shtyrë.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.8 Tatimi (vazhdim)

Tatimi i shtyre (vazhdim)

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra maten me normat e taksave që pritet të zbatohen në vitin kur aktivitet është realizuar ose detyrimi është shlyer, bazuar në normat e taksave (dhe ligjet tatimore) që janë miratuar në datën e raportimit

3.9 Provigjionet

Provigjionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, është e mundshme që një rrjedhje e burimeve që kanë përfitime ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit. Kur Shoqëria pret që disa ose të gjitha provigjionet të rimbursohen, për shembull, nën një kontratë sigurimi, rimbursimi njihet si një aktiv i veçantë, por vetëm kur rimbursimi është praktikisht i sigurt. Shpenzimi në lidhje me një provigjion paraqitet në pasqyrën e fitimit ose humbjes minus shumën e të ndonjë rimbursimi.

4. APLIKIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA

4.1 STANDARDET E PUBLIKUAR, POR, ENDE JO EFEKTIVE

Standardet dhe interpretimet e publikuar, por ende jo efektive, deri në datën e nxjerrjes së pasqyrave financiare të shoqërisë janë dhënë më poshtë. Shoqëria synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

Ndryshimet në SNRF 16: Koncesionet e qirave të lidhura me Covid-19 Më 28 maj 2020, BSNK ka nxjerrë amendimin për SNRF16 – Qiratë në lidhje me Koncesionet për qiratë e lidhura me Covid-19. Ndryshimet ofrojnë lehtësim për qiramarrësit nga zbatimi i udhëzimeve të SNRF 16 mbi modifikimin e kontabilitetit të qirasë për koncesionet e qirasë që vijnë si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë Covid-19. Si një mjet praktik, një qiramarrës mund të zgjedhë të mos vlerësojë nëse një koncesion qiraje në lidhje me Covid-19 nga një qiradhënësi është një modifikim i qirasë. Një qiramarrës që i bën këto zgjedhje llogarit për çdo ndryshim në pagesat e qirasë që rezultojnë nga koncesioni i qirasë në lidhje me Covid-19 në të njëjtën mënyrë që do të llogariste ndryshimin sipas SNRF 16, nëse ndryshimi nuk do të ishte një modifikim i qirasë. Ndryshimi zbatohet për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 qershorit 2020. Lejohet aplikimi më i hershëm. Qiradhënësit zbatojnë përshtatshmërinë praktike në mënyrë retrospektive, duke njohur efektin kumulativ të zbatimit fillestar të ndryshimit si një rregullim i balancës celëse së fitimeve të pashpërndara (ose përbërësit tjetër të kapitalit, siç është e përshtatshme) në fillim të periudhës raportuese vjetore në të cilën qiramarrësi aplikon për herë të parë ndryshimin. Në periudhën raportuese në të cilën një qiramarrës aplikon për herë të parë ndryshimin, qiramarrësi nuk është i detyruar të raportojë shumën e rregullimit për secilin zë të pasqyrave financiare të prekur dhe fitimet për aksion të kërkuara nga paragrafi 28 (f) i SNK 8. Shoqëria nuk pret ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat e saj financiare.

SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" (lëshuar më 18 maj 2017 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2021) Në maj 2017, BSNK botoi SNRF 17 Kontrata të Sigurimit (SNRF 17), një standard i ri gjithëpërfshirës i kontabilitetit për kontratat e sigurimit që përfshin njohjen dhe matjen, prezantimin dhe zbulimin. Pasi të jetë efektive, SNRF 17 do të zëvendësojë SNRF 4 Kontratat e Sigurimit (SNRF 4) që është botuar në 2005.

4. APLIKIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA (VAZHDIM)

4.1 STANDARDET E PUBLIKUARA, POR, ENDE JO EFEKTIVE (VAZHDIM)

SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" (lëshuar më 18 maj 2017 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2021) (vazhdim)

SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (dmth., Jete, jo-jete, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe risigurimi), pavarësisht nga llojin e subjekteve që i lëshojnë ato, si dhe për disa garanci dhe instrumente financiare me karakteristika të pjesëmarrjes diskrecionale. Do të zbatohen disa përjashtime nga fusha e veprimit. Objektivi i përgjithshëm i SNRF 17 është të sigurojë një model kontabël për kontratat e sigurimit që është më i dobishëm dhe i qëndrueshëm për siguruesit. Në ndryshim nga kërkesat në SNRF 4, të cilat bazohen kryesisht në politikat e mëparshme lokale të kontabilitetit, SNRF 17 ofron një model gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimit, duke mbuluar të gjitha aspektet e rëndësishme të kontabilitetit. Thelbi i SNRF 17 është modeli i përgjithshëm, i plotësuar nga:

- Një përshtatje specifike për kontratat me tipare të pjesëmarrjes direkte (qasja e tarifës së ndryshueshme)

- Një qasje e thjeshtuar (qasja e alokimit të primit) kryesisht për kontratat me kohëzgjatje të shkurtër SNRF 17 është efektiv për periudhat raportuese që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023, me shifrat krahasuese të kërkuara. Zbatimi i hershëm është i lejuar, me kusht që njësia ekonomike të zbatohet gjithashtu SNRF 9 dhe SNRF 15 në ose para datës që zbaton për herë të parë SNRF 17. Standardi nuk është miratuar ende nga BE. Nuk pritet që standardi të ndikojë në pozicionin financiar ose performancën e Shoqërisë.

SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit (Ndryshimet)", SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit (Ndryshimet)"

Ndryshimet në SNRF 17 janë efektive, në mënyrë retrospektive, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023, me leje zbatimi më të hershme. Ndryshimet synojnë të ndihmojnë kompanitë të zbatojnë Standardin. Në veçanti, ndryshimet janë krijuar për të ulur kostot duke thjeshtuar disa kërkesa në Standard, për ta bërë performancën financiare më të lehtë për t'u shpjeguar dhe për të lehtësuar tranzicionin duke shtyrë datën efektive të Standardit në 2023 dhe duke siguruar lehtësim shtesë për të zvogëluar përpjekjen e kërkuar kur zbatohet SNRF 17 për herë të parë. Ndryshimet në SNRF 4 ndryshojnë datën e vendosur në lidhje me afatin e përfundimit për përjashtimin e përkohshëm në SNRF 4 Kontratat e Sigurimit nga zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare, në mënyrë që njësive ekonomike të kërkohej të zbatonin SNRF 9 për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023. Ndryshimet në SNRF 17 nuk janë miratuar ende nga BE. Nuk pritet që ndryshimet të ndikojnë në pozicionin financiar ose performancën e Shoqërisë.

Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i Detyrimeve si Aktual ose Jo-aktual Në janar 2020, IASB botoi ndryshime në paragrafët 69 deri 76 të SNK 1 për të specifikuar kërkesat për klasifikimin e detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata. Ndryshimet sqarojnë:

- Çfarë nënkuptohet me të drejtën për të shtyrë pagesën
- E drejta për shtyrje duhet të ekzistojë në fund të periudhës së raportimit
- Klasifikim nuk ndikohet nga gjasat që një njësi ekonomike do të ushtrojë të drejtën e saj të shtyrjes
- Vetëm nëse një derivat me të drejtë konvertimi në një pasiv të konvertueshëm është vetë një instrument i kapitalit neto, kushtet e një pasivi nuk do të ndikojnë në klasifikimin e tij

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023 dhe duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive. Ndryshimet nuk janë miratuar ende nga BE. Shoqëria do të analizojë dhe vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të reja në pozicionin ose performancën e saj financiare.

Ndryshimet në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Aktivët afatgjata materiale; SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Pasuritë e Kushtëzuara si dhe Përmirësimet Vjetore 2018-2020 - Në maj të vitit 2020, BSNK botoi ndryshime në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit - Referencë në Kuadrin Konceptual. Ndryshimet kanë për qëllim të zëvendësojnë një referencë në Kuadrin për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare, të lëshuar në 1989, me një referencë në Kuadrin Konceptuale për Raportimin Financiar të lëshuar në Mars 2018 pa ndryshuar ndjeshëm kërkesat e saj.

4. APLIKIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA (VAZHDIM)

4.1 STANDARDET E PUBLIKUARA, POR, ENDE JO EFEKTIVE (VAZHDIM)

Ndryshimet në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Aktivët afatgjata materiale; SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Pasuritë e Kushtëzuara si dhe Përmirësimet Vjetore 2018-2020 (vazhdim)

Bordi gjithashtu shtoi një përjashtim në parimin e njohjes së SNRF 3 për të shmangur çështjen e fitimeve ose humbjeve të mundshme të 'ditës 2' që lindin për detyrimet dhe detyrimet e kushtëzuara që do të ishin brenda fushës së SNK 37 ose KIRFN 21 Taksa, nëse ndodhin veçmas. Në të njëjtën kohë, Bordi vendosi të sqarojë udhëzimet ekzistuese në SNRF 3 për aktivet e kushtëzuara që nuk do të ndikohen duke zëvendësuar referencën në Kuadrin për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 dhe zbatohen në prospektivë. Ndryshimet nuk janë miratuar ende nga BE. Shoqëria do të analizojë dhe vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të reja në pasqyrën e pozicionit ose performancës së saj.

Ndryshimet në Reformën e Referencës së Normës së Interesit - Faza 2 - SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16 - Në gusht të vitit 2020, BSNK publikoi Reformën e vlerësimit të Normës së Interesit - Faza 2, Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16, duke përfunduar punën e saj në përgjigje të reformës IBOR. Ndryshimet ofrojnë lehtësime të përkohshme të cilat adresojnë efektet e raportimit financiar kur një normë e ofruar ndërbankare (IBOR) zëvendësohet me një normë alternative interesi pa risk (RFR). Në veçanti, ndryshimet parashikojnë një mjet të përshtatshëm praktik kur llogariten ndryshimet në bazën për përcaktimin e flukseve monetare kontraktuale të aktiveve dhe detyrimeve financiare, për të kërkuar që norma efektive e interesit të rregullohet, ekuivalente me një lëvizje në një normë interesi në treg. Gjithashtu, ndryshimet përfshijnë lehtësime nga ndërprerja e marrëdhënieve mbrojtëse, duke përfshirë një lehtësim të përkohshëm nga plotësimi i kërkesës së identifikueshme vecmas kur një instrument RFR përcaktohet si mbrojtje e një komponenti rreziku. Për më tepër, ndryshimet në SNRF 4 janë krijuar për të lejuar siguruesit që janë duke zbatuar SNK 39 të marrin të njëjtat lehtësime si ato të parashikuara nga ndryshimet e bëra në SNRF 9. Ekzistojnë gjithashtu ndryshime në SNRF 7 Instrumentet Financiare: Shpjegimet për të mundësuar përdoruesit e pasqyrave financiare për të kuptuar efektin e reformës së normës së interesit në instrumentet financiare të një njësie ekonomike dhe strategjinë e menaxhimit të riskut. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021 me zbatim të lejueshëm më të hershëm. Ndërsa zbatimi është retrospektiv, nga njësia ekonomike nuk kërkohet të riparaqesë periudhat e mëparshme. Shoqëria do të analizojë dhe vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të reja në pasqyrën e pozicionit ose performancës e saj financiare.

Ndryshimet në SNK 16 Aktivët afatgjata materiale: Të ardhurat para përdorimit të synuar - Në maj të vitit 2020, BSNK botoi Aktivët afatgjata materiale - Të ardhurat para përdorimit të synuar, e cila ndalon njësitet ekonomike të zbresin nga kostoja e një elementi të aktiveve afatgjata materiale, çdo të ardhur nga shitja e sendeve të prodhuara ndërkohë që e sjellin aktivin në vendin dhe gjendjen e nevojshme që ai të jetë i aftë të funksionojë në mënyrën e parashikuar nga menaxhimi. Në vend të kësaj, një njësi ekonomike njih të ardhurat nga shitja e artikujve të tillë dhe kostot e prodhimit të këtyre artikujve, në fitim ose humbje. Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022 dhe duhet të zbatohet në mënyrë retrospektive për aktiveve afatgjata materiale të vendosura në dispozicion për përdorim në ose pas fillimit të periudhës më të hershme të paraqitur kur njësia ekonomike zbaton për herë të parë ndryshimin. Ndryshimet nuk janë miratuar ende nga BE. Shoqëria do të analizojë dhe vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të reja në pozicionin ose performancën e saj financiare.

Ndryshimet në SNK 37: Kontrata me kushte rënduesë - Kostot e përmbushjes së një kontrate Në maj të vitit 2020, BSNK botoi ndryshime në SNK 37 për të specifikuar se cilat kosto duhet të përfshijë një njësi ekonomike kur vlerëson nëse një kontratë është me kushtë rënduesë apo humbëse. Ndryshimet zbatojnë një "qasje të lidhur drejtpërdrejt me kostot". Kostot që lidhen drejtpërdrejt me një kontratë për të siguruar mallra ose shërbime përfshijnë si kostot rritëse ashtu edhe një alokim të kostove që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e kontratës. Kostot e përgjithshme dhe administrative nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me një kontratë dhe përjashtohen nëse nuk i ngarkohen palës tjetër në mënyrë të qartë sipas kontratës. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022. Ndryshimet nuk janë miratuar ende nga BE. Shoqëria do të analizojë dhe vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të reja në pozicionin ose performancën e saj financiare.

4. APLIKIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA (VAZHDIM)

4.1 STANDARDET E PUBLIKUARA, POR, ENDE JO EFEKTIVE (VAZHDIM)

SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar - Filiali si adaptues për herë të parë - Si pjesë e përmirësimeve të saj vjetore 2018-2020 në procesin e standardeve të SNRF, BSNK botoi një ndryshim në SNRF 1 Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Ndryshimi lejon një filial që zgjedh të zbatojë paragrafin D16 (a) të SNRF 1 për të matur ndryshimet kumulative të përkthimit duke përdorur shumat e raportuara nga shoqëria mëmë, bazuar në datën e kalimit të mëmës në SNRF. Ky ndryshim zbatohet gjithashtu për një ndërmarrje të përbashkët ose disa të përbashkëta që zgjedhin të zbatojnë paragrafin D16 (a) të SNRF 1. Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022 me zbatueshmëri të lejueshme më përpara. Ndryshimi nuk është miratuar ende nga BE. Nuk pritet që ndryshimet të ndikojnë në pasqyrën e pozicionit financiar ose të performancën së Shoqërisë.

SNK 41 Bujqësia - Tatimi në matjet e vlerës së drejtë - Si pjesë e përmirësimeve të saj vjetore 2018-2020 në procesin e standardeve të SNRF-ve, IASB botoi ndryshimin në SNK 41 Bujqësia. Ndryshimi heq kërkesën në paragrafin 22 të SNK 41 që njësitë ekonomike të përjashtojnë flukset e parave për tatimin kur matin vlerën e drejtë të aktiveve Brenda objektit të SNK 41. Një njësi ekonomike zbaton ndryshimin në mënyrë të mundshme për matjet e vlerës së drejtë në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2022 me zbatueshmëri të lejuar të mëparshme. Ndryshimi nuk është miratuar ende nga BE. Nuk pritet që ndryshimet të ndikojnë në pozicionin financiar ose performancën e Shoqërisë.

4.2 STANDARDET E PUBLIKUAR DHE EFEKTIVE PËR PERIUDHËN

Standardet e mëposhtme të ndryshuara u bënë efektive nga 1 Janari 2020, por nuk patën ndonjë ndikim material në Shoqëri:

Ndryshimet në SNRF 16: Koncesionet e qirave të lidhura me Covid-19

Më 28 maj 2020, BSNK ka nxjerrë amendimin për SNRF16 – Qiratë në lidhje me Koncesionet për qiratë e lidhura me Covid- 19. Ndryshimet ofrojnë lehtësim për qiramarrësit nga zbatimi i udhëzimeve të SNRF 16 mbi modifikimin e kontabilitetit të qirasë për koncesionet e qirasë që vijnë si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë Covid-19. Si një mjet praktik, një qiramarrës mund të zgjedhë të mos vlerësojë nëse një koncesion qiraje në lidhje me Covid-19 nga një qiradhënës është një modifikim i qirasë. Një qiramarrës që i bën këto zgjedhje llogarit për çdo ndryshim në pagesat e qirasë që rezultojnë nga koncesioni i qirasë në lidhje me Covid-19 në të njëjtën mënyrë që do të llogariste ndryshimin sipas SNRF 16, nëse ndryshimi nuk do të ishte një modifikim i qirasë. Ndryshimi zbatohet për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 qershorit 2020. Lejohet aplikimi më i hershëm. Qiradhënësit zbatojnë përshtatshmërinë praktike në mënyrë retrospektive, duke njohur efektin kumulativ të zbatimit fillestar të ndryshimit si një rregullim i balancës celëse së fitimeve të pashpërndara (ose përbërësit tjetër të kapitalit, siç është e përshtatshme) në fillim të periudhës raportuese vjetore në të cilën një qiramarrës aplikon për herë të parë ndryshimin. Në periudhën raportuese në të cilën një qiramarrës aplikon për herë të parë ndryshimin, qiramarrësi nuk është i detyruar të raportojë shumën e rregullimit për secilin zë të pasqyrave financiare të prekur dhe fitimet për aksion të kërkuara nga paragrafi 28 (f) i SNK 8. Këto ndryshime nuk kishin asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Ndryshimet në SNRF 3: Përkufizimi i një biznesi

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 me aplikim të mëhershëm të lejuar. Ndryshimet sqarojnë kërkesat minimale për një biznes dhe ngushtojnë përkufizimin e një biznesi. Ndryshimet gjithashtu heqin vlerësimin nëse pjesëmarrësit e tregut janë të aftë të zëvendësojnë ndonjë element që mungon, shtojnë udhëzime për të ndihmuar njësitë ekonomike të vlerësojnë nëse një proces i fituar është thelbësor dhe të prezantojnë një provë opsionale të përqendrimit të vlerës së drejtë. Këto ndryshime nuk kishin asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

4. APLIKIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA (VAZHDIM)

4.2 STANDARDET E PUBLIKUAR DHE EFEKTIVE PËR PERIUdhËN (VAZHDIM)

Ndryshimet në SNRF 7, SNRF 9 dhe SNK 39 Reforma e Vlerësimit të Interesit

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 dhe duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive. Zbatimi më i hershëm është i lejuar. Ndryshimet e botuara, trajtojnë çështje që ndikojnë në raportimin financiar në periudhën para zëvendësimit të një reforme ekzistuese të normës së interesit me një normë alternative interesi dhe adresojnë implikimet për kërkesat specifike të kontabilitetit mbrojtës në SNRF 9 Instrumentet Financiare dhe SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja, të cilat kërkojnë analiza të mëtejshme. Ndryshimet ofruan lehtësime të përkohshme, të zbatueshme për të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse që preken drejtpërdrejt nga reforma e normës së interesit, e cila mundëson që kontabiliteti mbrojtës të vazhdojë gjatë periudhës së pasigurisë përpara zëvendësimit të një standardi ekzistues të normës së interesit me një normë interesi alternative pothuajse pa risk. Ekzistojnë gjithashtu ndryshime në SNRF 7 Instrumentet Financiare: Shpjegimet në lidhje me informacionet shpjeguese shtesë rreth pasigurisë që vjen nga reforma e normës së interesit. Këto ndryshime nuk kanë asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Ndryshimet në SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet: Përkufizimi i 'materialitetit'

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 me zbatim më të hershëm aplikueshem. Ndryshimet sqarojnë përkufizimin e materialitetit dhe mënyrën se si duhet të zbatohet duke përfshirë në udhëzimet e përkufizimit që deri më tani ka paraqitur diku tjetër në Standardet e SNRF-ve. Ndryshimet gjithashtu specifikojnë se materialiteti do të varet nga natyra ose madhësia e informacionit. Këto ndryshime nuk kanë asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Kuadri Konceptual në standardet e SNRF-ve

BSNK ka nxjerre Kuadrin konceptual të rishikuar për Raportimin Financiar në 29 Mars 2018, i cili është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020. Kuadri Konceptual përcakton një seri gjithëpërfshirëse të koncepteve për raportimin financiar, përcaktimin e standardeve, udhëzimet për përgatitësit në zhvillimin e politikave të qëndrueshme të kontabilitetit dhe ndihmës për të tjerët në përpjekjet e tyre për të kuptuar dhe interpretuar standardet. Ndryshimet kryesore të paraqitura në kuadrin e rishikuar konceptual për raportimin financiar kanë të bëjnë me matjen, përfshirë faktorët, të cilët duhet të merren parasysh gjatë zgjedhjes së bazës së matjes, dhe me prezantimin dhe zbulimin, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet të cilat duhet të klasifikohen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Kuadri konceptual gjithashtu ofron përkufizime të perditesuara për aktivin dhe pasivin dhe kriteret për njohjen e tyre në pasqyrat financiare. Këto ndryshime nuk kishin asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Interpretimi i KIRFN 23 Pasiguria per Trajtimin ne lidhje me Tatimin mbi të Ardhurat

Interpretimi trajton kontabilitetin për tatimin mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasigurinë që ndikon në zbatimin e SNK 12 dhe nuk zbatohet për tatimet ose taksat jashtë fushëveprimit të SNK 12 dhe as nuk përfshin në mënyrë specifike kërkesat që lidhen me interesin dhe penalitetet në lidhje me trajtimin e pasigurt të tatimin.

Interpretimi trajton në mënyrë specifike sa vijon:

- Nëse një entitet i konsideron trajtimet e pasigurta tatimore veç e veç
- Supozimet që një entitet bën në lidhje me ekzaminimin e trajtimeve tatimore nga autoritetet tatimore
- Si një entitet përcakton fitimin e tatueshëm (humbje tatimore), bazat tatimore, humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore të papërdorura dhe normat tatimore
- Si një entitet i konsideron ndryshimet në fakte dhe rrethana

Një entitet duhet të përcaktojë nëse duhet të konsiderojë çdo trajtim tatimor të pasigurt veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera tatimore të pasigurta. Qasja që parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë duhet të ndiqet. Interpretimi është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020, por janë të disponueshme disa lehtësime të tranzicionit. Shoqëria do të zbatojë interpretimin nga data e hyrjes në fuqi. Meqenëse Shoqëria vepron në një mjedis tatimor në ndryshim, zbatimi i Interpretimit mund të ndikojë në pasqyrat e saj financiare dhe në zbulimet e kërkuara.

4. APLIKIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA (VAZHDIM)

4.2 STANDARDET E PUBLIKUAR DHE EFEKTIVE PËR PERIUdhËN (VAZHDIM)

Interpretimi i KIRFN 23 Pasiguria per Trajtimin ne lidhje me Tatimin mbi të Ardhurat (vazhdim)

Përveç kësaj, Shoqëria mund të ketë nevojë të krijojë procese dhe procedura për të marrë informacionin që është i nevojshëm për të zbatuar Interpretimin në kohën e duhur.

5. PËRCAKTIMI I VLERËS SË DREJTË

Matja e vlerës së drejtë

Shoqëria mat instrumentat financiarë si derivativët dhe aktivet jo-financiare të tilla si investimet ne prona, nëse ka, me vlerën e drejtë në çdo datë të bilancit. Vlera e drejtë është çmimi që do të merrej për të shitur një aktiv ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Matja e vlerës së drejtë bazohet me supozimin se transaksioni për të shitur aktivin ose transferuar detyrimin bëhet:

- Në një treg kryesor të aktivit apo detyrimit, ose
- Në mungesë të një tregu kryesor, në tregun më të favorshëm për aktivin ose detyrimin.

Tregu kryesor ose tregu më i favorshëm duhet të jetë i arritshëm nga Shoqëria.

Vlera e drejtë e një aktivi ose një detyrimi matet duke përdorur supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdorin kur vendosin çmimin e aktivit apo të detyrimit, duke supozuar që pjesëmarrësit e tregut veprojnë në interesin më të mirë ekonomik të tyre.

Një matje e vlerës së drejtë të një aktivi jo-financiar merr parasysh aftësinë e një pjesëmarrësi të tregut për të gjeneruar përfitime ekonomike duke përdorur aktivin në mënyrën më të mirë ose duke e shitur atë të një pjesëmarrës tjetër i tregut që do ta përdorte aktivin në mënyrën më të mirë.

Shoqëria përdor teknika vlerësimi që janë të përshtatshme në rrethanat dhe për të cilat ka të dhëna të mjaftueshme për të matur vlerën e drejtë, duke maksimizuar përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe duke minimizuar përdorimin e inputeve të pavëzhgueshme.

Të gjitha aktivet dhe detyrimet për të cilat vlera e drejtë matet ose paraqitet në pasqyrat financiare janë të kategorizuara brenda hierarkisë së vlerës së drejtë, të përshkruar si më poshtë, bazuar në nivelin me të ulët të inputit që është domethënës në matjen e vlerës së drejtë në tërësi:

(a) Niveli 1: Cmimet e tregut të kuotuar (të parregulluara), në tregjet aktive për aktive ose detyrime identikisht të njëjta.

(b) Niveli 2: Teknikat e vlerësimit, për të cilat niveli më i ulët i të hyrave që është i rëndësishëm në matjen e vlerës së drejtë është në mënyrë direkte ose indirekte i vëzhgueshëm.

(c) Niveli 3: Teknikat e vlerësimit, për të cilat niveli më i ulët i të hyrave që është i rëndësishëm në matjen e vlerës së drejtë është në mënyrë direkte ose indirekte i pavëzhgueshëm.

Shoqëria ka vetëm nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare jo-derivative (e cila përcaktohet vetëm për qëllime të paraqitjes) dhe vlera e drejtë nuk devijon nga vlerat e tyre kontabël.

6. Korrigjimi I gabimit

Gjatë vitit në shqyrtim Shoqëria identifikoi që pasqyrat financiare të vitit të kaluar përmbanin një gabim në lidhje me njohjen, prezantimin dhe shpjegimin e elementeve të raportuar në pasqyrat financiare. Në përputhje me SNK 8 - Politikat Kontabel, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabel dhe Gabimet, ky gabim korrigohet duke ridekluar balancën e celjes së kapitalit dhe balancat e periudhes krahasuese per çdo zë të prekur të bilancit dhe duke shpjeguar natyrën e gabimit dhe te dhenat e korrigjimit në një shënim të veçantë të pasqyrave financiare.

Në Tetor 2020, departamenti I kontabilitetit qendror (pergjegjes per raportimin financiar per Korporaten Microsoft) ka njohur dhe postuar në librat kontabel qendrore (te mbajtura ne SAP) për Shoqerine një të ardhur negative per komisionet në vleren 12,309 mije LEK (115,589,5 USD), një postim kontabel që do të shërbente për të korrigjuar një shumë të llogaritur dhe njohur teper të të ardhurave nga komisionet në të dy sistemet e llogarive kontabel (qendror dhe lokal) në vitin financiar 2020 të Microsoft (e cila përfshin periudhen 1 korrik 2019 - 30 qershor 2020).

Ndërkohë, paralelisht me postimin e kryer ne sistemin kontabel qendror ne SAP, Shoqëria postoi veprimin korrigjues te komisionit në tetor 2020, por për shkak të diferencave te mbartura në kursin e këmbimit midis librave kontabel qendror dhe lokal, shuma e faturuar në librat kontabel lokal është pak me e ulet 12,216.6 LEK (ose 112,450.3 USD).

Të ardhurat nga komisionet janë një burim i brendshëm i të ardhurave me të cilin Korporata Microsoft, synon të shpërblejë filialet e saj te vogla Microsoft, perfshire Shoqerine, për aktivitetet qe keto te fundit kryejne per zhvillimin të tregut dhe një e ardhur e tillë përcaktohet si mbulim i kostove operative neto (dmth. shuma e te ardhurave nga komisionet rezulton si difference midis kostove bruto operacionale te Shoqerise, te indeksuara per te perfshire normen e marzhit, dhe të ardhurave te gjeneruara nga sherbimet ndaj klientëve pale te treta). Të ardhurat e komisioneve llogariten bazuar në balancat e kontabilitetit qendror te Microsoft (te mbajtura ne SAP) dhe paralelisht njihen edhe ne kontabilitetin lokal.

Shoqeria gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit 2020, ka vlerësuar qe rregjistrimi korrigjues I postuar ne Tetor 2020, është ne fakt një korrigjim i nje gabimi të periudhës paraardhëse (2019), duke pasur parasysh që regjistrimi korrigjues ne fjale është kryer për të rregulluar ne ulje të ardhurat e komisioneve të njohura në 2019.

Prandaj, bazuar në dispozitat e SNK 8, Shoqëria bëri rregullimet në zërat e prekur te pasqyrave financiare të vitit 2019, duke dhënë më poshtë detajet e korrigjimit të gabimit dhe balancat e rideklaruara të vitit 2019.

Microsoft Albania sh.p.k.
Shenime te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

a) Rakordimi i Pasqyrës së Pozicionit Financiar

		31 Dhjetor 2019		Balancat e rideklaruar
		Para ndryshimit	Korrigjimi i gabimit	
Aktivët				
Aktive afatgjata materiale	7	12,656		12,656
E drejta e përdorimit të aktiveve	8	12,488		12,488
Aktive tatimore të shtyra		633		633
Totali i aktiveve afatgjata		25,777	-	25,777
Parapagime dhe shpenzime të periudhave të ardhme	9	1,741		1,741
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	10	65,255	(12,217)	53,059
Aktive tatimore	11	-		-
Paraja dhe ekuivalentet e saj	12	51,332		51,332
Totali i aktiveve afatshkurtra		118,328	(12,217)	106,111
Totali i aktiveve		144,105	(12,217)	131,888
Kapitali dhe detyrimet				
Kapitali aksionar	13	100		100
Fitimi i pashpërndarë		65,067	-	65,067
Fitimi i vitit		53,747	(10,390)	43,358
Totali i kapitalit		118,914	(10,390)	108,524
Detyrime afatgjata qiraje	14	8,063		8,063
Totali i detyrimeve afatgjata		8,063	-	8,063
Detyrime afatshkurtra qiraje	14	4,344	-	4,344
Detyrime kontraktuale	15	3,558	-	3,558
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	16	143	-	143
Provigjone për detyrime tatimore	17	1,854	-	1,854
Detyrime tatimore	18	7,229	(1,827)	5,402
Totali i detyrimeve afatshkurtra		17,128	(1,827)	15,301
Totali i detyrimeve		14,479	(1,827)	23,364
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		144,105	(12,217)	131,888

Shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 38 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

a) Rakordimi i Pasqyrës së fitim humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse

		31 Dhjetor 2019		Balancat e rideklaruar
		Para ndryshimit	Korrigjimi i gabimit	
Te ardhurat	19	123,261	(12,217)	111,045
Shpenzime amortizimi	7,8	(10,571)	-	(10,571)
Shpenzime personeli	20	(17,480)	-	(17,480)
Shpenzime operative të tjera	21	(30,225)	-	(30,225)
Fitimi operativ		64,985	(12,217)	52,769
Shpenzime interesi	22	(333)	-	(333)
Humbje nga kursi i këmbimit, neto	23	(97)	-	(97)
Fitimi para tatimit		64,555	(12,217)	52,339
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	24	(10,808)	1,827	(8,981)
Fitimi neto për vitin		53,747	(10,390)	43,358
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse		-	-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse		53,747	(10,390)	43,358

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbylltur në 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

7. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Kosto historike	Pajisje zyre	Mobilije dhe orendi zyre	Punime e riparime për ambientet me qira	Totali
Gjendja më 1 Janar 2019	9,133	5,859	16,735	31,726
Shtesa	901	-	-	901
Pakësime	(285)	-	-	(285)
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	9,749	5,859	16,735	32,342
Shtesa	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	9,749	5,859	16,735	32,342
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 Janar 2019	(7,648)	(3,053)	(2,982)	(13,684)
Amortizimi i vitit	(1,586)	(1,355)	(3,347)	(6,288)
Pakësime	285	-	-	285
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	(8,950)	(4,408)	(6,329)	(19,686)
Amortizimi i vitit	(685)	(1,355)	(3,347)	(5,387)
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	(9,635)	(5,763)	(9,676)	(25,073)
Vlera kontabël neto				
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	799	1,451	10,406	12,656
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	114	96	7,059	7,269

Disa artikuj nga kategoria "mobiljet e zyrës" dhe "përmirësimet e ambienteve të marra me qira" artikuj që i përkasin zyrës së dikurshme, me vlerë neto zero (që nga çelja e periudhës aktuale) do të hiqen përfundimisht nga inventari në periudhën e ardhshme, pasi Shoqëria të bëjë një njoftim zyrtar të organi tatimor sipas procedurës së përcaktuar nga legjislacioni shqiptar. Asnjë aktiv nuk është lënë peng si kolateral deri më 31 dhjetor 2020 (31 dhjetor 2019: asnjë).

8. E DREJTA E PËRDORIMIT TË AKTIVEVE

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
E drejta e përdorimit të aktiveve	22,361	22,361
Amortizimi i akumuluar	(14,345)	(9,873)
Vlera Kontabël	8,016	12,488

E drejta e përdorimit të aktiveve është njohur sipas dispozitave të SNRF 16 në lidhje me qiranë e zyrës për afatin e plotë të qirasë (1 tetor 2017 deri më 30 shtator 2021). Amortizimi i akumuluar përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur nga data fillestare e zbatimit të standartit.

Detaje të mëtejshme mbi njohjen fillestare, matjen dhe amortizimin e të drejtës së përdorimit të aktivitetit janë dhënë në shënimin shpjegues nr. 26 të këtyre Pasqyrave Financiare.

9. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË PERIUDHAVE TË ARDHME

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Garanci për qirane e zyrës	1,600	1,600
Parapagime furnitorëve	68	141
	1,668	1,741

Garancia për qiranë e zyrave është dhënë në përputhje me kontratën e firmosur. Parapagimet e kryera ndaj furnitorëve janë për shërbime që do të përfitohen në periudhën e pasardhese si shërbime interneti, sigurim makine, etj.

10. LLOGARITE E ARKETUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019 (e rideklaruar)
Llogari të arkëtueshme nga entitetet e grupit (Microsoft Global Finance)	43,360	55,642
Llogari të arkëtueshme nga klientë në lidhje me shërbimet MCS/PSS	3,869	3,808
Të ardhura të përlogaritura nga komisionet	6,098	(12,217)
TVSH e zbritshme	5,075	5,582
Aktive të tjera tatimore	223	223
Tatim në burim i arkëtueshëm	400	-
Totali	59,026	53,059

Shuma e të ardhurave të përlogaritura të raportuara për periudhën krahasuese lidhet tërësisht me korigjimin e kryer për vitin 2019 në lidhje me të ardhurat e komisionit dhe kjo shpjegohet më tej në detaje në shënimin 6 të Pasqyrave financiare "Korigjimi i gabimit". Vlera e përlogaritur e të ardhurave, në monedhën e dokumentit, arrin në 112,450.3 USD (e përkthyer me kursin e këmbimit në fund të vitit USD / LEK 108.64, shuma në LEK është 12,216 mijë).

Balanca e të ardhurave të llogaritura nga komisionet për v.2019 mbyllet në Tetor 2020 duke u faturuar (nuk preken të ardhurat e vitit 2020 nga ky faturim) duke përdorur kursin USD / LEK në datën e transaksionit (106.16), shuma në LEK është 11,937 mijë.

Në mbyllje të periudhës aktuale, Shoqëria llogariti të ardhura shtese nga komisionet bazuar në modelin e aplikuar (kosto neto plus), i cili zbatohet nga Korporata Microsoft (Shoqëria Mëme) për filialet vendore të Microsoft, duke përfshirë edhe Shoqërinë. Keshtu pas një një përlogaritje rezultoi që Shoqëria duhet të njëjto në llogarite e saj kontabel një vlerë shtesë prej 6,098 mijë LEK të të ardhurave nga komisionet për të bashkëruar rezultatin e saj operacionale me dispozitat përkatëse të modelit operacional të biznesit të sipërcituar

11. AKTIVE TATIMORE

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Tatim fitim i arkëtueshëm	8,059	-
Totali	8,059	-

12. PARAJA DHE EKUIVALENTET E SAJ

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Para në bankë	24,451	51,332
Llogari rrjedhëse në LEK	20,098	46,636
Llogari rrjedhëse në USD	4,353	4,696
Totali	24,451	51,332

13. KAPITALI AKSIONAR

	Më 31 dhjetor 2020		Më 31 dhjetor 2019	
	Numri i kuotave	LEK	Numri i kuotave	LEK
Microsoft Corporation	100	100	100	100
	100	100	100	100

Shoqëria është regjistruar në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në 30 qershor 2008 me NIPT K81830011C, me kapital të paguar prej 100,000 LEK i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1,000 Lek secila. Microsoft Corporation zotëron 100% të kuotave.

14. Detyrime Qiraje

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Detyrimi i Qirasë		
<i>Pjesa e detyrimit afatshkurtër të qirasë</i>	4,608	4,344
<i>Pjesa e detyrimit afatgjatë të qirasë</i>	3,584	8,063
Totali	8,191	12,407

Detyrimi i qirasë së bashku me të drejtën e përdorimit të aktivitetit të pasqyruara në shënimin shpjegues nr. 8 më lart të Pasqyrave Financiare, lidhen me qiranë e zyrës dhe janë njohur në përputhje me kërkesat e SNRF 16. Detyrimi i qirasë përfaqëson vlerën kontabël të njohur në aplikimin fillestar, të zvogëluar me pagesat e principalit të qirasë dhe rritur me vlerën e interesit të llogaritur dhe paguar deri më tani. Detaje të mëtejshme mbi njohjen fillestare dhe matjen e detyrimit të qirasë jepen në shënimin shpjegues nr.26 të Pasqyrave Financiare.

15. DETYRIME KONTRAKTUALE

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Detyrime kontraktuale	4,341	3,558
Totali	4,341	3,558

Të ardhurat e periudhave të ardhme përfaqësojnë të ardhura të periudhës në vijim për mjetet monetare të arketuara në avancë për shërbime që do kryhen bazuar në kontratat me klientët.

16. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Shpenzime të llogaritura	53	141
Detyrime ndaj furnitorëve	2	2
Tatimi mbi të ardhurat personale	1	(10)
Sigurime shoqërore	35	2
Totali	92	135

Shpenzimet e llogaritura në periudhën aktuale lidhen me shpërblimet dhe shërbimet e marra nga furnitorët për nevojat e operacionale të zyrës dhe shërbimet e konsulences. Furnitorët kanë lëshuar fatura në janar të vitit të ardhshëm.

17. PROVIJIONE PER DETYRIME TATIMORE

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Provigjione për detyrime tatimore	1,854	1,854
Totali	1,854	1,854

Provigjonet për detyrime tatimore në shumën 1,854 mijë LEK, të njohura fillimisht dhe të mbartura nga viti 2015 perfaqesojnë vlerën e detyrimeve të pritshme tatimore për tatim fitimin nga ndryshimi i deklaratave të tatim fitimit të periudhave të mëparshme.

18. DETYRIMET TATIMORE

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019 (e rideklaruar)
Tatim fitim i pagueshëm	-	5,410
Totali	-	5,410

19. TE ARDHURAT

	2020	2019 (e rideklaruar)
Të ardhura nga shërbimet MCS/PSS	14,988	84,319
Të ardhura nga komisionet	7,801	26,637
Të ardhura nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale	-	88
Totali	22,789	111,045

Të ardhurat nga shërbimet lidhen me kryerjen e shërbimeve e profesionale teknike të Microsoft (MCS) si dhe me shërbimet për mbështetje teknike (PSS) ofruar klienteve vendore pale te treta.

Të ardhura nga komisionet përfaqësojnë një burim të brendshëm të ardhurave që Microsoft Corporation shperblen filialet vendore të Microsoft për aktivitetet e zhvillimit të tregut që keto të fundit kryejne ne lidhje me produktet dhe shërbimet e Microsoft Corporation. Të ardhurat nga komisionet llogariten në bazë të metodës së kostos neto plus, pra duke zbritur nga vlera bruto e shpenzimeve operacionale totale të kryera (norma e indeksimit të shpenzimeve operacionale është pikerisht norma e marzhit të mbulimit të këtyre shpenzimeve), të ardhurat nga shërbimet e kryera ndaj klienteve pale te treta.

Sic e kemi shpjeguar edhe në Note 6 të Pasqyrave Financiare "Korrigjimi i gabimit", të ardhurat nga komisionet për vitin 2019 janë ulur me 12,217 mijë LEK.

Për periudhën aktuale, nga totali i të ardhurave nga komisionet të njohura, 7,682 mijë LEK, vlera prej 6,098 mijë LEK është njohur si e ardhur nga komisioni pas llogaritjes sipas modelit të zbatueshëm, duke përdorur të dhënat e pasqyrës së fitim humbjes të vitit 2020, sipas kontabilitetit vendor.

20. SHPENZIME PERSONELI

	2020	2019
Paga dhe përfitime të tjera	(3,170)	(17,595)
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	(396)	(669)
Shpenzime të tjera personeli (Pagesa bazuar në aksione)	-	784
Totali	(3,567)	(17,480)

21. SHPENZIME OPERATIVE TË TJERA

	2020	2019 (ndryshuar)
Shërbime të nënkontraktuara (MCS + Premier)	(3,266)	(18,087)
Shërbime ligjore dhe financiare	(1,031)	(2,971)
Mirëmbajtje	(908)	(1,381)
Internet	(754)	(735)
Qira	(223)	(2,494)
Pritje dhe përfaqësime	(182)	(375)
Telefon	(164)	(479)
Shpenzime zyre	(136)	(324)
Shërbime bankare	(104)	(302)
Shpenzime sigurimi	(50)	(90)
Shpenzime reklame	(38)	(1,147)
Shërbime postare	(30)	(38)
Gjoha	(11)	(335)
Shpenzime per transferimin e zyrave	-	(34)
Dieta-shpenzime udhëtimi dhe akomodimi	-	(2,150)
Provizijone dhe shpenzime te tjera jo të zbritshme	86	872
Shpenzime të tjera	(94)	(155)
Totali	(6,906)	(30,225)

Shërbime të nënkontraktuara përfshijnë kryesisht shërbime të lidhura me shërbime profesionale teknike (MCS) të marra nga furniturore pale te treta.

Provizijone dhe shpenzime të tjera jo të zbritshme përfshijnë provizijone per bonuse të përlogaritura per personelin dhe për shpenzime te konsideruara te pazbritshme per qellime tatimore.

22. SHPENZIME FINANCIARE, NETO

	2020	2019
Shpenzime Financiare	(238)	(333)
Totali	(238)	(333)

Shpenzimet financiare paraqesin pjesën e interesit të shpenzimeve të qirasë të llogaritura sipas SNRF 16, e cila është përlogaritur dhe paguar për periudhën aktuale.

23. (HUMBJA) /FITIMI NGA KURSI I KËMBIMIT

	2020	2019
Humbje nga kursi i këmbimit	(1,260)	(1,034)
Fitimi nga kursi i këmbimit	308	937
Totali	(953)	(97)

24. TATIMI MBI FITIMIN

Tatimi mbi fitimin për vitet e mbyllura më 31 dhjetor, 2020 dhe 2019 është i përbërë si më poshtë:

	2020	2019 (e ndryshuar)
Shpenzimi i periudhes aktuale per tatim fitimit 15% (2019: 15%) (përfshirë efektin e diferencave të përhershme)	(314)	(8,590)
Te ardhura /(shpenzime) nga tatimi i shtyrë (lindja dhe rimarrja l diferenca te perkohshme)	471	(391)
Shpenzimi i tatim fitimit	157	(8,981)

Norma standarde e tatimit për vitin, bazuar në normën standarde shoqiptare të tatimit mbi fitimin është 15% (2020: 15%); Shpenzimi për vitin mund të rakordohet me fitimin kontabël si në vijim:

	Norma efektive e tatimit	2020	Norma efektive e tatimit	2019 (rideklaruar)
Fitimi para tatimit		1,431		52,339
Tatimi mbi fitimin	15%	(215)	15%	(7,851)
<i>Efektivi tatimor i:</i>				
Shpenzimeve të pazbritshme	-7%	(99)	1.41%	(739)
Te ardhurat / (shpenzimi) për tatimin e shtyrë	32.88%	471	0.75%	(391)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin i njohur në fitim humbjen e vitit	10.97%	157	17.16%	(8,981)

E ardhura apo shpenzimi tatimor i shtyrë është njohur si rezultat i diferencave të përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve/detyrimeve dhe bazës së tyre tatimore, përkatësisht në lidhje me bonuset e llogaritura për punonjësit, aktivet afatgjata materiale si dhe shpenzimeve të qirasë, të llogaritura sipas SNRF 16.

Shpenzimet e pazbritshme perfaqesojne shpenzime biznesore të cilat nuk janë të mbështetura me dokumentacion të rregullt fiskal, si dhe penalitete tatimore dhe shpenzime të tjera që nuk lidhen me biznesin, të cilat janë të pazbritshme nga natyra.

25. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të arkëtueshme:		
Microsoft Global Finance	43,360	55,642
Total	43,360	55,642

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019 (e rideklaruar)
Të ardhurat e llogaritura nga komisionet		
Microsoft Global Finance	6,098	(12,217)
Total	6,098	(12,217)

Gjatë vitit Shoqëria raporton balancat totale te transaksioneve te mëposhtme me Microsoft Global Finance:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019 (e rideklaruar)
Te ardhura nga komisionet	7,801	26,637
Totali	7,801	26,637

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Paga dhe shperblime per drejtimin e Shoqerise	-	(13,254)
Total paga dhe shperblime	-	(13,254)

Per periudhen aktuale te raportimit nuk ka shpenzime paga dhe shperblime llogaritura apo paguara per drejtimin sepse nuk ka nje person te caktuar ne rolin e Drejtuesit te Pergjithshem te Shoqerise, nderkohe qe personi qe mbante kete rol, eshte larguar ne 31.10.2019.

26. SNRF 16 "Qiratë"

Shoqëria është palë e një kontrate qiraje, për qirane e zyrës në Tiranë, e cila i është nënshtruar aplikimit të SNRF 16, marrëveshja me numër 091017-OLA-1205 e lidhur me Gener 2 Shpk (qiradhënësi). Afati i qirasë së kontraktuar është 5 vjet (60 muaj), me datë fillimi 1 tetor 2017 dhe përfundon në 30 Shtator 2021.

Efektet në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e të fitim apo humbjes si rrjedhojë e zbatimit të SNRF 16 paraqiten më poshtë:

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	<u>Qiraja e zyrës</u>	<u>Totali</u>
Gjendja më 1 Janar 2019	22,361	22,361
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Amortizimi i vitit	(9,873)	(9,873)
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	12,488	12,488
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Amortizimi i vitit	(4,308)	(4,308)
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	8,180	8,180

Vlerat kontabel te detyrimeve te qirase te njohura sipas SNRF16, dhe levizjet e ketyre detyrimeve sipas periudhes, jane paraqitur me poshte:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Me 1 Janar	12,407	17,506
Interesi i llogaritur dhe paguar	238	333
Pagesat e detyrimit te qirase	(4,660)	(4,541)
<i>Rregullim diferenca nga kursi i kembimit</i>	206	(890)
Me 31 Dhjetor	8,191	12,407
<i>Detyrime afatshkurtra</i>	4,607	4,344
<i>Detyrime afatgjata</i>	3,583	8,063

26. SNRF 16 "Qiratë" (vazhdim)

Shumat e njohura në fitim dhe humbje:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Shpenzimi i amortizimit për të drejtën e përdorimit të aktivit	(4,308)	(4,283)
Shpenzimet e interesit mbi detyrimin e qirasë	(238)	(333)
Pagesat e principit të qirasë	4,660	4,541
Detyrimi tatimor i shtyrë i njohur në lidhje me diferencën e vlerës kontabël dhe bazës tatimore të shpenzimit të qirasë:	(17)	11
Totali i shpenzimit i njohur në fitim dhe humbje	97	(64)

27. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Një instrument financiar është çdo kontratë që bën të mundur krijimin e një të drejte për të marrë mjete monetare ose aktive të tjera financiare nga një palë tjetër (aktiv financiar), ose krijimin e një detyrimi për t'i transferuar mjete monetare ose aktive të tjera financiare një pale tjetër (detyrim financiar). Instrumentat financiarë e ekspozojnë Shoqërinë ndaj disa rreziqeve. Më të rëndësishmet janë paraqitur më poshtë.

a) Rreziku i kredisë

Instrumentat financiarë, të cilat e bëjnë Shoqërinë subjekt të rrezikut të kredisë, konsistojnë kryesisht në llogari të arkëtueshme të tjera dhe mbajtje të parave. Rreziku i kredisë i Shoqërisë manaxhohet duke vendosur mjetet e saj monetare në institucione financiare me cilësi të lartë.

Maksimumi i rrezikut të kredisë ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar në datën e pasqyrës së pozicionit financiar është si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019 (e rideklaruar)
Llogari të arkëtueshme tregtare	59,026	53,039
Para në bankë	24,451	51,332
TOTALI	83,477	104,370

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019 (e rideklaruar)
Brenda afatit dhe jo të zhvlerësuara	83,477	104,370
Mbas afatit por jo të zhvlerësuara	-	-
Të zhvlerësuara	-	-
TOTALI	83,477	104,370

b) Rreziku i likuiditetit

Shoqëria siguron vazhdimësi të financimeve. Huatë e saj janë të ndara në hua dhe qira financiare. Fleksibiliteti afatshkurtër arrihet duke mbajtur mjete të mjaftueshme monetare dhe duke përdorur lehtësirat e overdraftit, sipas nevojës. Më poshtë janë paraqitur maturitetet e kontraktuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare, duke përfshirë edhe pagesat e interesit deri më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

31 dhjetor 2020	Vlera kontabël	Më pak se 6 muaj
<i>Aktive financiare</i>		
Llogari të arkëtueshme tregtare	59,026	59,026
Paraja dhe ekuivalentet e saj	24,451	24,451
Totali	83,477	83,477
<i>Detyrime financiare</i>		
Te ardhura te shtyra	4,341	4,341
Llogari të pagueshme dhe të tjera	92	92
Totali	4,432	4,432
Pozicioni neto	79,044	79,044

31 dhjetor 2019	Vlera Kontabël	Më pak se 6 muaj
<i>Aktive financiare</i>		
Llogari të arkëtueshme tregtare	53,039	53,039
Paraja dhe ekuivalentet e saj	51,332	51,332
Totali	104,370	104,370

27. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Detyrime financiare

Te ardhura te shtyra	3,558	3,558
Llogari të pagueshme dhe të tjera	5,545	5,545
Totali	9,103	9,103
Pozicioni neto	95,267	95,267

c) Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut nga kursi i këmbimit sidomos në lidhje me financimet përmes qirave financiare si dhe në lidhje me komisionet nga Microsoft Corporation në lidhje me marketingun dhe aktivitetet e zhvillimit. Këto marrëveshje më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë kryer në USD. Shoqëria nuk ka përdorur instrumenta derivative për të kufizuar ekspozimin e saj ndaj rrezikut nga kursi i këmbimit dhe normat e interesit. Aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë sipas monedhave më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

31 dhjetor 2020	Vlera kontabël	EUR	USD	LEK
<i>Aktive financiare</i>				
Llogari të arkëtueshme tregtare	59,026	3,869	43,360	11,797
Paraja dhe ekuivalentet e saj	24,451	-	4,353	20,098
	83,477	3,869	47,713	31,895
<i>Detyrime financiare</i>				
Te ardhura te shtyra	4,341	-	-	4,341
Llogari të pagueshme dhe të tjera	92	-	-	92
	4,432	-	-	4,432
Ekspozimi neto	79,044	3,869	43,511	27,463

31 dhjetor 2019 (e ndryshuar)	Vlera kontabël	EUR	USD	LEK
<i>Aktive financiare</i>				
Llogari të arkëtueshme të tjera	59,450	3,808	55,642	-
Paraja dhe ekuivalentet e saj	51,331	-	4,696	46,636
	110,782	3,808	60,338	46,636
<i>Detyrime financiare</i>				
Te ardhura te shtyra	3,558	-	-	3,558
Llogari të pagueshme dhe të tjera	5,545	-	-	5,545
	9,103	-	-	9,103
Ekspozimi neto	101,649	3,808	60,338	37,533

Analiza e ndjeshmërisë ndaj valutave të huaja

Analiza e ndjeshmërisë është përcaktuar në bazë të ekspozimit ndaj monedhave të huaja në datën e raportimit dhe ndryshimet e parashikuara në fillim të vitit financiar dhe të mbajtura konstante gjatë periudhës së raportimit. Më poshtë është vlerësimi i efekteve të ndryshimit të kurseve të këmbimit në fitimin neto, duke mbajtur të gjitha variablat e tjera konstante. Tabela tregon fitimin (humbjen) në Lek kur monedhat e huaja (EURO, USD) vlerësohen ose zhvlerësohen me 10% kundrejt Lekut.

27. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

c) Rreziku i kursit të këmbimit

	2020		2019	
	EUR	USD	EUR	USD
Monedha zhvlerësohet me 10%			(381)	(6,033)
Monedha vlerësohet me 10%			381	6,033

d) Rreziku i normave të interesit

Rreziku i normave të interesit është rreziku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të ndryshimeve në normat e interesit të tregut ka të bëjë kryesisht me detyrimet afatgjata të qerasë financiare me norma interesi të ndryshueshme. Shoqëria nuk angazhohet në instrumenta mbrojtës.

28. ANGAZHIME DHE GARANCI

Çështje gjyqësore

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë procesi gjyqësor, padie apo çështje gjyqësore të ngritur gjatë aktivitetit normal të biznesit.

29. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Shoqëria ka nënshkruar dy marrëveshje të reja shërbimi PSS, me Qeverinë Shqiptare (AKSHI) dhe me një klient të palës së tretë (IKUB info shpk) përkatësisht më 8 Shkurt 2021 dhe 17 Mars 2021. Këto kontrata do të rrisin ndjeshëm burimet e jashtme të të ardhurave dhe performancën financiare të Kompanisë gjatë gjithë vitit 2021.

Pas datës së raportimit nuk ka patur ndonjë ngjarje, e cila do të kërkonte ndryshime apo paraqitje shtesë në pasqyrat financiare.